

Dhjetor 2025

BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

TRYEZË E RRUMBULLAKËT E ORGANIZUAR NË KUADËR TË 16 DITËVE TË SENSIBILIZIMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE



Zëvendësministrja e Drejtësisë znj. Elona Hoxha mori pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore. Synimi kryesor i kësaj tryeze ishte theksimi i rolit kyç të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në mbrojtjen e viktimave të dhunës.

ANALIZA E KUADRIT LIGJOR TË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

U zhvillua tryeza e diskutimit mbi analizën e kuadrit ligjor të ndihmës juridike falas. Të pranishëm në këtë takim ishin Zëvendësministrja e drejtësisë znj. Elona Hoxha, Kreu i Prezencës së OSBE në Shqipëri, z. Michel Tarran, Drejtoresha e Përgjithshme e Komanduar e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, znj. Patricia Pogaçe si dhe eksperti z. Vangjel Kosta.



MEKANIZMI I REFERIMIT TË RASTEVE NË NDËRMJETËSIM NGA OFRUESIT E NDIHMËS JURIDIKE FALAS



Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mori pjesë në takimin me temë: “Mekanizmi i referimit të rasteve në ndërmjetësim nga ofruesit e ndihmës juridike falas”, i organizuar në kuadër të projektit “Mbështetja e aksesit të qytetarëve në drejtësi nëpërmjet ndërmjetësimit në Shqipëri” në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve, CSSP-Berlin Center for Integrative Mediation dhe në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

TË DREJTAT E TË MOSHUARVE NË SHQIPËRI

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Prezenca e OSBE në Shqipëri me temë: “Të drejtat e të moshuarve në Shqipëri: Gjetjet përfundimtare mbi qasjen në shërbime dhe ndikimin e digjitalizimit”. Fokusi kryesor i aktivitetit ishte prezantimi i rezultateve të aktiviteteve tematike të vlerësimit dhe monitorimit të Prezencës së OSBE në Shqipëri, të kryera gjatë viteve 2024-2025, duke u përqëndruar në të drejtat e personave të moshuar, qasjen e tyre në shërbime sociale dhe ndikimin e digjitalizimit në ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.



TAKIME TË ORGANIZUARA NË BASHKËPUNIM ME UNHCR NË SHQIPËRI



“No justice system is complete if the most vulnerable remain without real access to legal representation. Partnership with UNHCR helps us strengthen standards and ensure that legal protection is accessible to everyone.”

Patricia Pogace
Director General (in charge) Free Legal
Aid Directorate

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas mori pjesë në aktivitetet e zhvilluara nga UNHCR të cilat synonin rritjen e ndërgjegjësimit mbi ndihmën juridike falas për refugjatët, personat që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe personat me rrezik për të mbetur pa shtetësi.



“Legal aid works best through cooperation. We are committed to providing free legal aid to asylum-seekers and refugees by strengthening the legal framework and our nationwide network.”

Sindri Prifti, Specialist
Free Legal Aid Directorate
Ministry of Justice of Albania

MBROJTJA E KONSUMATORËVE DHE ADRESIMI I SHQETËSIMEVE



Përfaqësues nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas morën pjesë në aktivitetin me temë: “Prezantimi i gjetjeve të ankesave të konsumatorëve dhe shqetësimeve të ngritura nëpërmjet pyetësorit”, në kuadër të projektit “Linja e Gjelbër për Mbrojtjen e Konsumatorit - Siguria ushqimore dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në Shqipëri nëpërmjet fuqizimit të OSHC-ve lokale”.

AKTIVITETE TË QENDRAVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE



QSHNJP Përmet dhe QSHNJP Gjirokastrë në datën 03.12.2025, në bashkëpunim me ndërmjetësen e DHKN, organizuan një tjetër aktivitet sensibilizues pranë Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, me pjesëmarrjen aktive të studentëve të fakulteteve të ndryshme. Aktiviteti kishte temën: “Dita Botërore të Personave me Aftësi të Kufizuara”.

QSHNJP Përmet dhe QSHNJP Gjirokastrë në datën 03.12.2025, pranë Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, zhvilluan një aktivitet sensibilizues në kuadër të javës së dytë të fushatës ndërkombëtare “16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës në Familje”



QSHNJP Përmet në datën 11.12.2025 organizoi një aktivitet informues në ambientet e Zyrës së Punës Përmet, në kuadër të Ditës Botërore të Drejtave të Njeriut.

QSHNJP Mat, në datën 03.12.2025, zhvilloi takime informuese me persona me aftësi të kufizuara në ambientet e zyrës, me rastin e “3 Dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar”



QSHNJP Mat, në datën 04.12.2025, mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”



QSHNJP Mat, në datën 10.12.2025, zhvilloi një prezantim informues në ambientet e një prej shkollave të qytetit të Burrelit, me rastin e “10 Dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut”, me qëllim prezantimin e historikut, qëllimit dhe ndërgjegjësimin për këtë ditë botërore, të pasqyruara edhe përmes një fletëprezantimi.

QSHNJP Mat, në datën 10.12.2025 mori pjesë në aktivitetin përmbyllës në kuadrin e “16 Ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore”, aktivitet i organizuar nga Bashkia Mat.



QSHNJP Mat mori pjesë në takimin e Ekipit Teknik Ndërsektorial (ETN), të zhvilluar pranë zyrës së Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Mat, ku u trajtuan rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare.



QSHNJP Elbasan zhvilloi një aktivitet informues në formën e “Street Law” më datë 04.12.2025 në kuadër të 3 Dhjetorit, Dita Botërore e Personave me Aftësi të Kufizuar.

QSHNJP Korçë, në datën 02.12.2025, zhvilloi një takim informues dhe ndërgjegjëses në Shkollën e Mesme të Përgjithshme “Raqi Qirinxhi”, në kuadër të fushatës ndërkombëtare “16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social, Policinë dhe Komisionerin për Mbrojtje nga Diskriminimi.





QSHNJP Korçë, në datën 02.12.2025, zhvilloi një takim informues dhe ndërgjegjësues në fasonerinë “Thoma Tasho”, në kuadër të fushatës ndërkombëtare “16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kujdesit Social, Policinë dhe Komisionerin për Mbrojtje nga Diskriminimi.

QSHNJP Korçë, në datën 03.12.2025, zhvilloi një takim informues dhe ndërgjegjësues në Shkollën e Mesme të Përgjithshme “Themistokli Gërmenji”, në kuadër të fushatës ndërkombëtare “16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”.



QSHNJP Korçë, në datën 04.12.2025, zhvilloi një takim informues dhe ndërgjegjësues me studentët e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane, në kuadër të fushatës ndërkombëtare “16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”

QSHNJP Korçë, në datën 10.12.2025, zhvilloi një takim informues me qytetarë mbi ndihmën juridike dhe të drejtat e njeriut, në kuadër të Ditës Botërore të të Drejtave të Njeriut.



QSHNJP Korçë, në datën 15.12.2025, mori pjesë në mbledhjen e Komitetit Drejtues të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje



QSHNJP Gjirokastrë, në datën 03.12.2025, zhvilloi një takim pune me përfaqësues të UNHCR-it dhe Kryqit të Kuq Shqiptar, me fokus projektin “Monitorimi i Kufirit dhe Mbështetja e Azilkërkuesve dhe Refugjatëve në Shqipëri”



QSHNJP Gjirokastrë, në datën 12.12.2025 zhvilloi një intervistë me median RTCJ me temë: “Interesi i qytetarëve mbi shërbimet ligjore falas, rastet e dhunës në familje, shërbimet e tjera më të kërkuara”.

QSHNJP Vlorë, në datën 16.12.2025, zhvilloi një aktivitet informues në kuadër të “Ditës Botërore të Personave me Aftësi të Kufizuar”, pranë Shoqatës së Invalidëve Para dhe Tetraplegjik, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqatave që operojnë në qytetin e Vlorës.





QSHNJP Lezhë në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, mori pjesë në aktivitetin sensibilizues të dedikuar fëmijëve me aftësi të kufizuara.



QSHNJP Lezhë, në datën 10.12.2025, me rastin e “Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut”, mori pjesë në aktivitetin përmbyllës të fushatës “16 Ditë të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”,



QSHNJP Lezhë, në datën 16.12.2025, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional për adresimin e rasteve të dhunës në familje, mori pjesë në takimin e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor (ETN).

QSHNJP Lezhë, në datën 17.12.2025, zhvilloi një takim pune me juristen Erina Lesaj pranë Shërbimit të Provës, ZV Lezhë, e cila mbulon rastet e të miturve në konflikt me ligjin.



QSHNJP Fier, në datën 05.12.2025, zhvilloi një aktivitet informues në kuadër të “Ditës Botërore të Personave me Aftësi të Kufizuar”, me punonjësit e Njesisë Administrative Qendër, Bashkia Fier.



QSHNJP Fier, në datën 12.12.2025, zhvilloi një takim informues me qytetarë pranë Njesisë Administrative Qendër, Bashkia Fier.



QSHNJP Fier, në datën 22.12.2025, zhvilloi një takim në bashkëpunim me organizatën “Voice of Roma in Albania”, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), institucionet lokale të Fierit dhe disa nxënës nga Shkolla e Kurseve Profesionale Fier.

QSHNJP Kukës, me datë 12.12.2025, mori pjesë në takimin me temë: “Bashkëpunimi efektiv Këshilli Bashkiak Kukës– Shoqëria Civile”.



QSHNJP Kukës, më datë 05.12.2025, mori pjesë në konsultimin publik me objekt “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës për vitin 2026”, i organizuar nga Bashkia Kukës, me pjesëmarrjen e komunitetit dhe institucioneve vendore.



QSHNJP Kukës, më datë 09.12.2025, mori pjesë në takimin me temë “Fund dhunës digjitale ndaj grave dhe vajzave”, i zhvilluar në kuadër të Fushatës Ndërkombëtare të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Gruas dhe Dhunës në Familje





QSHNJP Tropojë, në datën 10.12.2025, në kuadër të fushatës kombëtare “16 Ditë Aktivizëm kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, në bashkëpunim me shkollën “Ali Podrimja”, organizoi një aktivitet ndërgjegjësues me pjesëmarrjen e nxënësve të klasave të VIII-ta dhe IX-ta.

QSHNJP Kavajë dhe Durrës, me datë 03.12.2025, morën pjesë në aktivitetin e organizuar nga Shoqata e Paraplegjikëve dhe Tetraplegjikëve, Dega Durrës, në kuadër të Ditës Botërore të Personave me Aftësi të Kufizuara, pranë Qendrës Kulturore të Fëmijëve Durrës.



QSHNJP Kavajë dhe Durrës, në kuadër të fushatës ndërkombëtare “16 Ditë Aktivizëm kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, zhvilloi një sesion informues me nxënësit e Gjimnazit “Aleksandër Moisiu”, Kavajë.

QSHNJP Durrës, në bashkëpunim me QSHNJP Kavajë, në kuadër të 10 Dhjetorit – Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, zhvilloi një aktivitet informues “Street Law” në qytetin e Kavajës.



QSHNJP Shkodër në datën 02.12.2025, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, zhvilloi një takim me përfaqësueset e Shoqates së invalidëve Para-Tetraplegjike të Shqipërisë, Dega Shkodër.

QSHNJP Shkodër në datën 02.12.2025, në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore, zhvilloi takim me Koordinatorën Vendore të Dhunës, Bashkia Shkodër.



QSHNJP Shkodër në datën 02.12.2025, në kuadër të Javës së Personave me Aftësi të Kufizuara, mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Bashkia Shkodër me temë: “Për një të Ardhme Gjthëpërfshirëse dhe të Qendrueshme”.

QSHNJP Shkodër në datën 04.12.2025, në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore, në bashkëpunim me Qendrën Komunitare “Për familjen”, zhvilluan një takim informues pranë kësaj qendre.



QSHNJP Gjirokastrë në datën 29.12.2025 zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues me temë: “Ndihma juridike për grupet vulnerabël”.



QSHNJP Fier, në datën 29.11.2025, mori pjesë në një aktivitet në Njësine Administrative Strum, Bashkia Roskovec.



